



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1387/2 prot.,

Datë: 02.06.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Cekani” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-44959-04-14-2025, me objekt “Per hartimin e planit te mbareshtimit te ekonomise pyjore kullosore Zerqan, NjA Zerqan, Bashkia Bulqize” me fond limit 9,976,833.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 02-05-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqize.

Ankimues: Operatori ekonomik “Cekani” SHPK me NIPT J77617616R dhe adresë Lagjia nr. 1, Bulevardi Gjorg Golemi, Godina nr. 2, me nr. Pasurie 8/190, Librazhd.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Bulqize
Lagjia “Minatori”, Bulqizë

Në datën 30.05.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1387/1 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5350 e operatorit ekonomik “Cekani” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-44959-04-14-2025, me objekt ‘Per hartimin e planit te mbareshtimit te ekonomise pyjore kullosore Zerqan, NjA Zerqan, Bashkia Bulqize’ me fond limit: 9976833.0 (nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 02-05-2025 nga autoriteti kontraktor, BASHKIA BULQIZE.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Cekani” SHPK.

Bazuar në gërmën “b”, të pikës 4, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “CEKANI” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1387/1 prot., datë 30.05.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5350.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

OE nuk ploteson kriterin 2.3.1, pune te ngjashme te deklaruar nuk jane realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, sic specifikohet ne DST, piken 2.3.1.

Gjithashtu në ankesë operatori ekonomik ngre pretendimet si vijon:

“a. Ekspertizë teknike:

- Mbi rishikimin nga Komisioni Vlerësimit dokumentacionin e paraqitur për konkurrim nga subjekti Cekani shpk konkretisht fatura tatimore të likujdimet nr. 3/2022 datë 21.11.2022, mbi punimet e ngjashme të kryera prej tij dhe që janë brenda periudhës 3 vjecare dhe 5 vjecare [...]

b. Ekspertizë juridike/ligjore.

- Konflikti interest të ekipit Teknik të subjekteve lidhur me detyrën për realizimin e hartimit të planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, deklarata e pjesëtarëve të ekipit [...]

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 02.06.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro